



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI,
I MBAJTUR MË 29.03. 2016**

**SA JAVNE DEBATE KOMISIJE ZA EKONOMSKI RAZVOJ,
INFRASTRUKTURU, TRGOVINU I INDUSTRIJU, ODRŽANE
29.3.2016. GODINE**

**MARS
2016**

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri,
Kryetar i Komisionit z. Muhamet Mustafa

KRYETARI: Mirëdita të gjithëve,
Më lejoni që të hap këtë dëgjim publik me rastin e diskutimit të projektligjeve të pakos së energjisë që kanë të bëjnë me Ligjin për energjinë, Projektligjin për gazin natyror, Projektligjin për rregullatorin e energjisë dhe Projektligjin për energjinë elektrike.

Ju përshëndes të gjithëve,
Ju falënderoj për pjesëmarrje,
Në mbledhje pos anëtarëve të Komisionit kemi përfaqësuesit e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomike,
Kemi gjithashtu edhe përfaqësues tjerë të organizatave të shoqërisë civile, ekspertë dhe kemi ekspertin e angazhuar nga Komisioni profesor Ali Hamitin.

Besoj që sot do të kemi rastin që të shkëmbejmë mendimet për disa nga çështjet më të rëndësishme, çështjet kyçe që kanë të bëjnë me këto katër ligje të cilat përbëjnë një pako të rëndësishme të harmonizimit të legjislacionit tonë me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane dhe sidomos me kërkesat e komunitetit të energjisë elektrike.

Rëndësia e këtyre ligjeve është jashtëzakonisht e madhe sepse ato duhet të sigurojnë një furnizim cilësor të mjaftueshëm të bizneseve dhe të konsumatorëve familjarë me energji elektrike me çmime të pranueshme dhe standarde të nevojshme të cilësisë.

Këto ligje sigurisht se shënojnë një avancim të mëtejshëm të këtij sektori për rregullimin e këtij sektori, politikat e nevojshme dhe menaxhimin dhe qeverisjen si dhe ndërlidhen e akteve të ndryshme, përgjegjësi dhe kompetencave të tyre për qeverisjen e këtij sektori jashtëzakonisht të rëndësishëm.

Natyrisht që çështja e sektorit të energjisë në Kosovë ballafaqohet me shumë probleme për shkak të ngecjeve të investimeve, ngecjeve në zhvillim dhe për shkak të kapaciteteve për menaxhimin dhe qeverisjen e këtij sektori të rëndësishëm.

Mendoj se me këto ligje ne bëjmë një hap shumë të rëndësishëm. Prandaj, ju kemi ftuar që sot me kontributet e tyre të shtroni çështjet që janë për diskutim lidhur me këto ligje për ndonjë përmirësim eventual, amendamentim të teksteve me të cilat duhet të procedojmë domethënë pas kësaj mbledhje ne kalojmë do të kalojmë drejtpërdrejtë në formulimin e amendamenteve nëse ka nevojë për ndonjë çështje të caktuar dhe nëse nuk ka nevojë atëherë, besoj që duhet të ketë nevojë, disa çështje i kemi diskutuar edhe në Komision në leximin e parë, disa çështje duhet të ketë nevojë që të riformulohen por në përgjithësi më lejoni të them që këto projektligje kanë një standard shumë të mirë të punës.

Para se të shkojmë më tutje, unë e kisha lutë përfaqësuesin e Ministrisë zotin Sabit Gashin që t'i thotë disa fjalë lidhur me këto projektligje.

SABIT GASHI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar pjesëmarrës këtu,

Ministria e Zhvillimit ekonomikë si përgjegjëse për zhvillimin e sektorit të energjisë bazuar në detyrimet që ka ndaj komunitetit të energjisë por bazuar edhe në nevojat që ka sektori i energjisë për të hapur në tregun rajonal të energjisë.

Në vitin 2013 ka filluar procesin e hartimit të legjislacionit të ri të sektorit të energjisë bazuar në pakon e tretë të legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Ajo që është themelore që të thuhet këtu është se pakoja e tretë ka disa kërkesa themelore për të gjitha palët kontraktuale të cilat obligohen që të krijojnë infrastrukturën ligjore po edhe infrastrukturën institucionale dhe përgjegjësish rregullativën e saj për të ju përshtatur kërkesave të tregut të energjisë.

Kërkesë themelore për këtë kanë qenë mund të themi tri, kërkesa themelore që janë të komunitetit të energjisë përkatësisht të Bashkimit Evropian janë transimion plotësisht i pavarur në kuptimin e pronësisë, në kuptimin se transimioni jonë ka qenë i pavarur po thuaj se në tërësi sa i përket .. përditshëm . Mirëpo kërkesa e re e Bashkimit Evropian është që monitorimi dhe zgjedhja e bordit të bëhet në mënyrë të tillë që të mos ketë kurrfarë ndikimi, kurrfarë konflikti me gjenerimin.

Kërkesë tjetër e pakos së tretë është një rregullator plotësisht i pavarur i energjisë.

Kërkesë tjetër sa i përket legjislacionit është derregullimi i gjenerimit të energjisë elektrike. Deri më tani ne e dimë që gjenerimi i energjisë është plotësisht i rregulluar dhe kërkesa e komunitetit të energjisë është kjo të jetë i derregulluar në një farë forme që të hapet tregu për furnizim tregu me shumicë.

Edhe përcaktimi është një kërkesë tjetër, përcaktimi më i qartë i obligimeve të shërbimit publik kur obligohet ndërmarrjet e energjisë për të ofruar shërbime publike, cili është roli i shtetit dhe roli i sekretariatit të komunitetit të energjisë edhe kjo ka qenë kërkesë e kësaj pakoje.

Jemi munduar si hartues të legjislacionit që t'i përshtatim, kemi kërkuar edhe ndihmën e ekspertëve të sekretarit të komitetit të energjisë, ata kanë qenë mjaftë të involvuar që prej fazës fillestare të procesit e deri në përfundimin e drafteve.

Po ashtu dokumenti ka qenë në diskutim publik sipas udhëzimit administrativ për hartimin e akteve ligjore e të tjera me radhë.

Mendojmë që është bërë një punë e mirë, punë që do të vlerësohet nga ju në fund dhe ju do të jepni vulën asaj pune tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Gashi.

Tash po e hapim diskutimin, mund të ketë edhe pyetje eventuale edhe komente të ndryshme.

Në aspektin tonë është shumë e rëndësishme që të sigurojmë një standard të profesionalizmit dhe pavarësisë së trupave rregulluese dhe bordeve të ndërmarrjeve që janë kyçe për këtë sektor siç është KEK-u, KOST-i, ZRRE-ja, edhe natyrisht rregullimi edhe më i mirë i KECI-it si një operator privat për një shërbim publik.

Domethënë këto natyrisht që shpeshherë përvojat janë delikate, ne kemi operatorin privat po ai kryen një shërbim publik edhe shpeshherë hapen disa çështje që janë të rëndësishme lidhur me prokurimin, lidhur me shërbimet, lidhur me të ardhurat e lejuara kështu që edhe aty nevojitet një situatë e re.

Sa i përket bordeve ne kemi, derisa dikush të paraqitet ne kemi diskutuar edhe më herët që bordet e agjencioneve të pavarur tash e tutje natyrisht që do të shohim në aspektin ligjor të pavarësisë së tyre por edhe zgjedhjes së tyre, domethënë mënyrës së votimit. Kështu që sigurisht aty do të jepni amendament sepse Kuvendi ka aprovua disa rekomandime apo jo, të përgatitur një amendament, a do të votohet në pako për të gjitha apo për secilin veç e veç, aty ka qenë një kërkesë më herët e jona.

Çështja tjetër që kemi shtrua ka qenë për këtë operatorin e tregut apo si u quante ai Sabit, domethënë çështja e operatorit të tregut që duhet të shkojmë bashkë edhe me profesor Hamitin edhe me të tjerë, të shohim sa është ai vendi, ku është ai dhe cilat funksione i merr ai dhe ato punë që i ka krye dikush tjetër deri tash çka bëhet me atë organ sepse ne në Kosovë po e kemi një praktikë që edhe ato punë janë kryer deri më tash, formohet një organ i ri një institucion i ri dhe administrata duplikohet. Domethënë në qoftë se dikush është marrë me ato punë atëherë mundet ai trup mu pavarësua edhe me i krye këto punë, apo do të krijohet krejtësisht i ri. Domethënë ne jemi të stërngarkuar me administratë dhe me agjencione të pavarura dhe këtë çështje duhet ta shohim.

Te çështja e rregullatorit, janë disa çështje që janë shumë të rëndësishme që i kemi bisedua por ato janë më tepër te çështja e vendosjes së rregullatorit, çështjet e strukturës së çmimit të cilat me këtë ligj sigurisht nuk mundën të rregullohet por le të rregullohen eventualisht me aktet përcjellëse edhe kriteret mënyrën e formimit të çmimit, për arsye se ka pasur shumë diskutim që konsumatorët që e paguajnë rrymën, energjinë rregullisht duhet të paguajnë për konsumatorë që nuk e paguajnë rrymën dhe ka humbje edhe teknike. Natyrisht që kjo çështje nuk është për të diskutuar sot por është një nga çështjet që na pret në të ardhmen.

Sot ju kisha lut që më tepër të përqendrohemi në këto ligje që i kemi para vete.

Urdhëroni! Ai që e merr fjalën çoftë për pyetje, çoftë për diskutim le të prezantohet. Urdhëroni, ju lutem!

DARDAN ABAZI: Përshëndetje për të gjithë,
Dardan Abazi, nga Instituti INDEP.

Dua të përshëndes Komisionin për organizimin e këtij dëgjimi publik, është shumë e rëndësishme që të diskutojmë sot për këto ligje të energjisë edhe pse sot ky dëgjim po organizohet për të gjitha ligjet njëherazi. Unë mendoj që trajtimi i tyre duhet të jetë një nga një për shkak se edhe të volumit të madh por edhe të rëndësisë që ka secili nga to.

E inkurajoj ministrinë që të sjell në Kuvend edhe Ligjin për efikasitetin e energjisë për shkak se edhe ai ligj e komplimentin këtë pako.

Ne siç e dini kemi rekomanduar por është kërkesë edhe e institucioneve evropiane për formimin e Fondit për efikasitetin të energjisë ose eko-fondit. Unë mendoj që do të rregullonte dhe do të ndihmonte shumë sektorin e energjisë në Kosovës.

Sa i përket pakos ligjore e cila është sjell në Kuvend, nuk ka dyshim që ajo është një hap më tutje në avancimin dhe në hapjen e tregut do të thotë më tepër, për shkak se ky është edhe qëllimi kryesor i pakos së tretë legislative.

Duhet thënë që jemi pak vonë me këtë pako të legjislationit. Siç e dini në Kuvend kjo pako kishte ardhur edhe përpara shpërbërjes së Kuvendit në legjislaturën e kaluar dhe kemi një ngecje në adoptimin e saj.

Sa i përket disa elementeve në këtë pako, unë do të thotë që fillimisht tek Ligji për energji do të duhej të kishte një definim të ndryshëm të stabilimenteve të reja dhe atyre ekzistuese.

Traktati i komunitetit të energjisë dhe sekretariati i saj kërkon që të paktën të bëhet një ndarje në mes të stabilimenteve deri në vitin 2006 dhe stabilimenteve pas vitit 2006 pa pas hyrjes në fuqi të këtij traktati.

Tek neni 10, i Ligjit për energji, tek planet zhvillimore të operatorëve të sistemit të transmissioinit dhe të distribucionit mendoj që megjithëse ka një përmirësim të dukshëm në definimin në këtë nenë. Do të duhej që të ishte edhe obligative bërja e këtyre planeve publike. Për shembull ZRRE-ja e ka të publikuar në VEP saj të vetëm planin zhvillimor të operatorit të transmissioinit të cilin kemi pasur qase për ... të distribucionit nuk kemi pasur qasje dhe kemi pasur mjaftë vështirësi në sigurimin e këtij plani zhvillimor.

Për më tepër ky plan zhvillimor nuk parasheh investime të distribucionit do të duhet që këto elemente të jenë parasysh.

Sa i përket të drejtave pronësore po ashtu kemi një vërejtje, më tepër një lloj sqarimi që duhet bërë dhe duhet shikuar sidomos në kuptim të kompetencave të komunave, sepse unë mendoj që këtu po lihen jashtëzakonisht anash komunat.

E dini që kemi pasur disa probleme të disa komunave me stabilimente të operatorit të distribucionit dhe unë mendoj që planet rregullative komunale duhet të merren para sysh përpara se këto servitute të barten te kompanitë energjetike sepse në këto forma ato po barten pa kurrfarë pasoje ose pa kurrfarë konsiderate ndaj planeve komunale.

Edhe një çështje, është çështja e rregullatorit për energji. Unë mendoj që kjo është një prej çështjeve për të cilat komisioni mund më së shumti me pas vërejtje dhe me pas përmirësim në legjislacion.

Kryesisht dhe në mënyrë fundamentale mendoj që zgjedhja e anëtarëve të bordit është elementi kyç që siguron edhe funksionalitet por edhe pavarësi të institucionit.

Siç e dini i kemi dy qëndrime sa i përket rregullatorit për energji, një që vjen nga raporti i progresit që thotë se funksionaliteti dhe pavarësia e Zyrës së Rregullatorit për Energji për shumë kohë është mbizotuar nga ndikimet politike, nga kapaciteti i ulët administrativ dhe mungesa e burimeve njerëzore.

Po ashtu në raportin e Sekretariatit të Energjisë thuhet që procedura e zgjedhjes së anëtarëve të bordit të Rregullatorit për Energji dhe mungesa e një skeme rotacioni si dhe autonomisë së plotë buxhetore e pengojnë pavarësinë e institucionit.

Unë mendoj që zgjedhja e fundit e anëtarëve në bordin e ZRRE-së dhe diskutimet që janë bërë në këtë Komision kanë nxjerr disa rekomandime mjaftë të mira, për shembull zgjedhja individuale në Bordin e ZRRE-së është mjaftë e rëndësishme që të bëhet. Për këtë ka një përmirësim në këtë pako ligjore por duhet edhe më tej të sqarohet.

Mandati jo i njëjtë duhet të jetë në kuptim të vitit jo të njëjtë të skadimit të mandatit dhe jo vetëm në datën e skadimit të mandatit. Për shkak se në qoftë se kemi një sistem rotativ ashtu siç ka kërkuar edhe Sekretariati për energji

në të cilin për një vit vetëm njëri prej anëtarëve të bordit do t'i skadonte mandati. Atëherë në një formë do të kishim funksionalitet të ZRRE-së edhe në qoftë se për dy vite nuk ka zgjedhje të anëtarit të bordit të ZRRE-së.

E ne e dimë që kriza politike ose ngërçe të ndryshme po na shkaktojnë kohë të gjatë të mos funksionalitetit ose edhe thjeshtë refuzimi i Qeverisë që të administroj procesin e zgjedhjes së anëtarëve në bordin e ZRRE-së.

Po ashtu tek papajtueshmëria për zgjedhjen e kemi një vërejtje shumë thelbësore.

Ne mendojmë që anëtarët pa dashur të kontestojnë mandatin e këtyre që janë zgjedhur tashmë, por zgjedhja e anëtarëve të Bordit të ZRRE-së duhet të jetë e bazuar në profesionalizimin e tyre e assesi në petkun partiak.

Duhet të vendosen ndoshta dispozitat e ligjit për ndërmarrjet publike e cila ndalon anëtarët të cilët kanë qenë politikisht aktiv në 36 muajt e fundit që të zgjedhën anëtarët e bordit të ZRRE-së.

Edhe për shkak të ndjeshmërisë së punës që kanë këta anëtarë dhe për shkak të vendimeve të ndjeshme që këta marrin. Ne mendojmë që pavarësia nga petku partiak është kyçe për pavarësinë e institucionit në përgjithësi.

Ne do t'i dërgojmë edhe me shkrim këto vërejtjet tona dhe shpresoj që Komisioni do të bëjë punë të mirë dhe përvoja jonë në këtë komision tregon që puna në grupe bëjnë shumë kujdes dhe besoj që do të ketë përmirësime të mëtutjeshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

VISAR HOXHA: Visar Hoxha prej KOST-it.

Përsëritës kryesuesin, deputetë edhe pjesëmarrësit tjerë,

Më lejoni të përgëzoj pjesëmarrësit prej Ministrisë së Zhvillimit të cilët kanë bërë një punë të mirë në grupet punuese në të cilat edhe KOST-i edhe ndërmarrjet tjera publike kanë marrë pjesë në procesin e hartimit.

Ne si ndërmarrje publike kemi qenë pjesë e grupeve punuese dhe kemi kontribuar me aq sa kemi pasur mundësi.

Ndërsa pas leximit të parë të Kuvendit i kemi pasur edhe disa vërejtje paka shumë të natyrës teknike të cilat i kemi përcjell në sekretarin e Komisionit. Besoj se ato ose janë prezantuar ose do të prezantohen ndërkohë.

Një çështje ...

Rëndësi e cila sipas mendimit tonë nuk është adresuar tërësisht, apo nuk është zgjedh është çështja e shthurjes pronësore e cila u përmend tërthorazi nga zoti Sabit edhe nga kryesuesi që ka të bëjë kryesisht me emërimet e bordit të drejtorëve edhe me kërkesat tjera.

Kjo çështje është parakusht për certifikimin e KOST-it si operator i sistemit të transmissiionit në Kosovë. Kjo gjithashtu implikon edhe pjesëmarrjen e KOS-it në mekanizmat regional. Domethënë, ne si KOS pikëpamjet tona i kemi shpreh edhe propozimet edhe gjatë punës në grupet punuese, por për arsye të ndryshme ato nuk janë zhvilluar më tej në grupet punuese dhe ka mbetur në konsideratë të ministrisë.

Besoj që drafti aktual që është i ligjit së paku me një dispozitë kalimtare duhet të adresojë këtë çështje, nëse ne sipas mendimit tim kjo nuk është zgjidhje finale është përcaktuar që Qeveria do ta zgjedh këtë çështje, por në dispozitat kalimtare nuk ka zgjidhje për aspektin kohor apo çështje e cila e sanksionin këtë punë, nuk besoj se është forumi ndoshta me ju marrë kohë për me i elaboruar propozimet tona, por mbesin në dispozicion për çfarëdo kërkesë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Hoxha! Unë mendoj që ju mund ta jepni formulimin e juaj çka nevojitet, mandej e trajtojmë bashkarish me grupin punues.

Një çështje që unë desha ta ngris këtu megjithëse është çështje këtu ne e thamë më tepër e formulimit teknik, thotë atje që është në pronësi të KOS-it, unë mendoj që ky sistemi energjik është nën menaxhim të qeverisje të KOS-it përndryshe pronësia është e Kosovës. Kështu që këtë çështje desha të diskutoj që ta kem parasysh ajo më ka ra në sy kur e kam lexuar, nuk e di në anglisht ndoshta është një tjetër formulim, por mendoj se pronësia e KOS-it është e popullit të Kosovës e Kosovës është e publikut, në interesin publik.

Por, ajo jepet në menaxhim të KOS-it, por duhet të shitet edhe tjetër kund se urdhëro, ti...

VISAR HOXHA: Po, zoti kryesues. Ashtu thuhet në ligj është parakusht i kërkesave të pakos të tretë edhe kërkesave tjera të Bashkimit Evropian. Por, dihet KOS-ti si subjekt juridik është 100% në pronësi të Qeverisë. KOS-ti formulimit se pronësia është e KOS-ti është thjeshtë për çështje praktike, se nëse do të ishte ndryshe nëse pronësia do të ishte e dikujt tjetër e KOS-ti veç e menaxhon atë çfarëdo veprimi lidhur me ato asete kishte me qenë çështje burokratike me thënë.

Po dihet struktura e operimit të KOS-it si ndërmarrje publike është e rregulluar me Ligjin për ndërmarrjet publike edhe me një varg ligjesh tjera që besoj se shumë mirë e rregullojnë edhe e përcaktojnë suazat e veprimit. Për atë arsye besoj që nocioni se asetet janë në pronësi të KOS-it besoj që është e duhur, se edhe KOS-ti është 100% në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRETARI: Le të shikohet, domethënë na po e dimë këtë punë e dimë të gjithë, megjithatë është një çështje që duhet të shihet formulimi, por në qoftë se është një standard evropian atëherë ne duhet të përputhemi me atë patjetër, nuk mund të formulojmë diçka tjetër. por, në esencë dihet pronësia, domethënë është e qartë pronësia.

Urdhëroni!

BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Përfaqësues të institucioneve,

Unë do të pajtohesha ndoshta që në fillim me zotin Abazi që ligjet do të duhet t'i trajtojmë një nga një, në mënyrë që të kemi qartësi të trajtimit edhe të neneve për të cilat do të flasim.

Unë besoj që të gjitha ligjet janë të një rëndësie të veçantë, por në raport me Kuvendin dhe në raport me tërë sektorin e energjisë besoj që Ligji për rregullatorin e energjisë është ligji më domethënës në kuptimin e rregullimit dhe këtu pastaj të gjitha çështjet sa i përket licencimit, kontrollimit, monitorimin, ndaljen e licencave, raportin me komuna janë gjëra të cilat janë të specifikuara dhe duhet të specifikohen me këtë ligj.

Marrë parasysh që rregullatori parimisht i rregullon edhe subjektet publike edhe ato private, që operojnë pra po flasim për një sektor të rregulluar

energjetik dhe që realisht edhe KEDS-i si operator privat është i obliguar që të furnizojë, pra është si i tillë i nënshtrohet rregullave të rregullatorit, sigurisht që çështjet e parimit të njëjtë do të zbatohen për këtë, për të gjithë subjektet, të cilët janë aktualisht të cilët potencialisht mund të vijnë si rezultat i liberalizimit të tregut.

Një çështje që është një kohë të gjatë në diskutim dhe kisha dashur, por nuk po mund ta gjej në ligj ndoshta se kam shikuar me vëmendje të veçantë është raporti e komunave dhe Zyrës së Rregullatorit tek licencimi. E kemi çështje e cila është mjaftë diskutabile për shkak se procedurat aktuale qysh janë, janë që aplikimi bëhet në zyre të Rregullatorit, pastaj Zyra e Rregullatorit ka një periudhë 90 ditore, pra tre muaj për të thënë është e pranuar apo nuk është e pranuar licenca, ndërsa komunat kanë kompetenca etj., për dhënie të lejeve të cilat paraprakisht jepen me vendimet e kuvendeve komunale dhe këto na paraqesin situata të cilat janë jo fort mirë të rregulluara sipas mendimit tim personal.

Pse po e them këtë? Sepse, kemi pas raste në Shqipëri dhe kemi edhe në Kosovë, kanë marrë ndërmarrje të cilat nuk kanë kapacitete as profesionale, as financiare për të ndërtuar të themi mini-hidrocentrale apo kapacitete të energjive tjera të ripërtitshme dhe kjo në një formë për dy vjet e ka bllokuar plotësisht hapësirën në mënyrë që të gjejnë investitor potencial, mos të them për të gjithë për ta shit at licencë te dikush tjetër.

Pra, kjo është gjendja aktuale të cilën e kemi neve në treg. Propozimi im është që të shikohet, këtu e kemi edhe profesorin i cili është në këtë lëmi shumë mirë i fokusuar dhe e ka përvojën edhe shkencore, por edhe institucionale që ta shohim se si mund ta rregullojmë këtë çështje. Ndoshta Rregullatori do të duhej që parimisht të gjitha ato kërkesa që shkojnë atje ta jep një vlerësim të vetin profesional a kanë kapacitet ndërmarrjet që aplikojnë në komunë apo nuk kanë kapacitet për të ndërtuar edhe financiar edhe profesional, në mënyrë që të mos i bllokojmë ne për momentin sa kam unë informacion gati tërë pikat për hidro-energji janë të licencuara parimisht, por të cilat nuk ka ndonjë aktivitet ekonomik, sepse s'kanë fuqi as financiare as ndonjë historiat të mundësisë për investim.

Pra, në këtë pikë kisha kërkuar ndoshta është momenti, ne këtë çështje e kemi diskutuar prej kohës kur unë kam qenë ministër dhe profesori ka qenë kryetar i Zyrës së Rregullatorit dhe mendoj që është momenti tash që ta rregullojmë do të thotë në mënyrë të tillë që të jetë sa më funksionale.

Pra, mbi këtë bazë kisha kërkuar që ta rregullojmë çështjen e lëshimit të licencave dhe obligimeve, të cilat i kanë dhe për energjitë e ripërtrishme, për licencat e reja në përgjithësi. Dhe ndoshta do të duhej të vihet një limit....

Ndoshta edhe do të duhej të bëhet një limit në rast se dikush e merr licencën dhe 6 muaj nuk fillon operimet t'i merret licenca. Faleminderit!

KRYETARI: Është çështje që ka shumë ankesa te këto investimet për shembull ose konsumatorët familjarë një fshat bëhen bashkë, ose për shembull bizneset investojnë në një transformator edhe mandej pronësia mbetet e diskutueshme e merr KEDS-i po e di që është e zgjedhur, por ata po ankohen mandej ata kanë investuar dhe po e merr pa pare KEDS-i atë.

Epo në rregull, e di që ka pasur ankesa.... apo me e mbajt vetë po janë mirëmbajtjet edhe janë shumë çështje që kanë ngjall probleme.

BESIM BEQAJ: Nëse më lejohet në këtë temë, kjo është çështje e rregulluar me ligj ata kanë opsion ose ta lënë në shfrytëzim të ia kthejnë pronësinë dhe në shfrytëzim dhe në mirëmbajtje, përkujdesje operatorit ose munden me e mbajt në pronësi të veten dhe me u marr të gjitha obligimet për vete. Pra, është çështje e cila është rregulluar me ligj sigurisht që munden me pas ankesa, por që në parim zgjedhja është e tyre nuk mund të themi që tani ata nuk kanë ndonjë zgjedhje.

KRYETARI: Unë e di që është zgjedhje e atyre, por është obligim i KEDS-it ose i sistemit energjetik që tu ofrojnë njerëzve furnizim që do të thotë të ju ofrojë edhe transformatorin. Meqenëse ata shpeshherë nuk janë në gjendje me ua ofru këtë e ndërtojnë ata vetë, atëherë është një çështje një investim që për mua është e rregulluar, por po shkakton diskutime. Vazhdojmë më tutje kush ka ndonjë çështje.

Urdhëroni, ju lutem!

MENTOR MORINA: Faleminderit, kryetar!

Mentor Morina prej Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Nuk e di ndoshta është një koment sa i përket ose ndonjë gabim lëshim teknik pak tek Projektligji për energji elektrike neni 46, ... konsumatorëve të cënueshëm paragrafi 11 për trajtimin e varfërisë së energjisë pak çka është kuptuar këtu apo ka qenë ndonjë lëshim ndoshta mund, do të ishte mirë ndoshta me e

harmonizuar çka është menduar në këtë aspekt për mos me mbet sa i përket...

Sa i përket neneve tjera pothuajse është në përputhje me atë dhe programet aktuale që janë duke u zbatuar nga Qeveria në aspektin e mbështetjes së konsumatorit të cenueshëm apo subvencionimit të energjisë elektrike.

SABIT GASHI: Ka mundësi që të jetë si po thotë deputeti çështje e përkthimit megjithëse njihet si në termin anglisht njihet varfëria e energjisë, neve ndoshta nuk na vjen tamam në konceptin tonë gjuhësor.

ALI HAMITI: Ju faleminderit! Po, Ali Hamiti jam unë. Jam i caktuar ekspertë për të rishikuar pak në tërësi këto ligje, të cilat për mua janë shumë të njohura se unë kam punuar në këto ligje dhe paraprakisht në fazën e përgatitjes së tyre në një projekt tjetër dhe unë i përgëzoj të gjithë ata që kanë punuar dhe e kanë dorëzuar një pako të mirë të sektorit të energjisë dhe të ligjeve që at sektor e rregullojnë.

Mund të them që Kosova sa i përket regjionit është më elegante në këtë aspekt, sepse ka më së shumti ligje për sektorin e energjisë se plot të tjerë e kanë vetëm një ligj dhe të gjitha quhet ligji akti për energjinë dhe të gjitha çështjet rregullohen me një ligj kryesisht, edhe në kojshi, por edhe jashtë po e them quhet vetëm një akt i energjisë dhe çdo gjë rregullohet në të. Ne kemi më së shumti absolutisht, kemi 4-5 ligje që lëmit e caktuara të sektorit të energjisë dhe të aktiviteteve rregullohen me ligje të veçanta që s'ka kurrëgjë të keqe.

... e vetme është që ligjet kanë nevojë të harmonizohen sepse ka përsëritje mes tyre nganjëherë edhe jo ... nuk janë të mëdha, janë të riparueshme, por janë të nevojshme absolutisht edhe për nga përmbajtja edhe për nga forma dhe po ashtu harmonizimi i tyre dhe heqja e ... që ka përsëritje, por gjithashtu edhe temat e njëjta në ligjet e ndryshme quhen ndryshe dhe ka pastaj dilema cila nga shprehjet, cilat nga termet është e qëlluara se pastaj njëri thirret te tjetri. Secila thotë që këto që s'kemi thënë këtu janë ligje tjera, por tash ku me marrë at ligjin e parë nëse je ti tu u marr me një ligj domethënë së paku ato termet kryesore që i përkasin një lëmie duhet të jenë qoftë edhe të përsëritshme të jenë në ligjin e veçantë që ai ligj kur te kesh përpara të mos kesh dilema dhe t'i shpalosësh edhe pesë ligje tjera me pa se ku është ai term i përkthuar.

Pastaj, është edhe renditja e tyre çështje teknike, por gjithkund fillohet me A e mbarohet me ZH te ne, i keni parë termet aty nuk janë të renditura sipas alfabetit që nganjëherë sjell telashe, se ti e lyp me A e del në fund e ZH-ja është e para, kur të duhet një term ta gjesht praktikisht është mirë ato të renditen në bazë të alfabetit se gjithkund ashtu bëhen ose tematike, njërën ose tjetrën duhet njërën prej parimeve me e ndjek.

Në terminologji ka probleme relativisht të mëdha, por të riparueshme po ashtu, është çështje po e zëmë tek termi i konsumatori i ceneshem mua më duket që s'është adekuate, sepse i ceneshem është i sakatosur praktikisht, jo fukara, por në nevojë kryesisht shqip edhe fjala shqipe “konsumatorë në nevojë” “in need” edhe në anglisht edhe në të gjitha gjuhët tjera është okej edhe nuk preket kurrkush që është nën nevojë pse i ndihmon si term dhe është i përshtatshëm se ka ndryshe – ndryshe po kryesisht ata konsumatorë me ndihma sociale s'di i quajmë diqysh ndryshe nuk e di si është, sepse ju të ministrisë ju kisha lut se këtu e kemi praktikisht konsumatorët që janë nën nevojë e nuk marrin ndihma sociale dhe një tjetër kategori është që s'kanë mundësi ta paguajnë edhe pse s'marrin ndihmë sociale.

Domethënë janë dy edhe në ligj janë dy terme. ... që është kanë tash ato kartat blu që i kanë praktikisht tash të gjithë ata që i kanë karta blu automatikisht konsiderohen si në nevojë dhe i marrin ato beneficione që i ofron ligji. Por, ka edhe tjerë që janë ose me baza tjera në nevojë edhe ata duhet ta gëzojnë këtë të drejtë po ashtu. Tjera terme ka probleme edhe terminologji kjo është po e zëmë ka 7-8 lloje tarifë, çmim, pagesë, kosto, shpenzim, qargj që i thonë ngarkesë, pagesë, tarifë, tatim, taksë e përzier ne themi.

Shumë vende tash njëra me tjetrën kështu që duhet me ndjek një parim se ka plot, plus edhe kompensim. Të gjitha janë me pare paguhen, do caktohen, do janë çmime, do janë taksa që cakton dikush, tatimin e cakton dikush tjetër, ZRE-ja cakton taksa me ju marrë atyre me jetu vetë etj., etj., janë disa lloje pagesash taksash, ngarkesash, kompensimesh.

Tjetër çka kisha, po ashtu është mirë që mungojnë 4-5 terme që janë shumë të rëndësishme po e zëmë e komunitetit e sektorë tjera të komunitetit, palët e treta kush janë etj. etj., nuk janë të qarta, e 100 herë përmenden dhe me detyrim dhe ju drejtohen me kompetencë. Kështu që janë 4-5 ..., Rregullatori i komunitetit etj., etj., janë 4-5 terme që duhet që janë qenësore, sepse

përmenden thirren disa herë në ligj e kurrkund nuk shpjegohen kush është, çka janë ato. Duhet të përkufizohen si term ose shprehje po i them.

Po ashtu, ka tjera, është problemi te Ligji i Gazit se te gasi kurrkund nuk përmendet gazi i lëngët ose lëngëzimi i gastit dhe as ... lëmia që merret me atë punë, domethënë Ligji për ... është kryesisht nuk e kemi tash për tash, por është mirë që qysh tani të përcaktohen dhe të definohen termet e nevojshme. Se gazi nuk dihet kur vjen në Kosovë edhe kur do ta kemi por paraprakisht duhet të bëhet infrastruktura se edhe me ardh gazi pa infrastrukturë veç vjen kot i bien gypat nëpër Kosovë.

Pra, ndërtimi i kapaciteteve duhet të fillojë menjëherë dhe duhet të përqendrohet ligji në mënyrën e ndërtimit të infrastrukturës për gaz që tani, se deri të bëhemi konsumatorë të gazit kanë me shkuar edhe nja pesë vjet, por edhe më shumë ishalla për pesë vjet vjen, por kryesorja do të duhej të nisej infrastruktura që tani. Kështu që ajo pjesë duhet të precizohet edhe pak, se nuk është mjaftueshëm e rregulluar se si duhet të caktohet menjëherë praktikisht....

... askush s'merret me ndërtime, bordet për to, operatorët për gasin, operatori i sistemit, mandej rregullatori, obligimet që ka për gasin, e tjera, e tjera... plus, ka termine tjetër që s'është përmendur, gasi veç transmetohet edhe po dua të them, transmetohet po edhe praktikisht bartet, është termi tjetër. Eh bartje dhe transmision, shqip dhe anglisht është njësoj, bartja është ekuivalente në transmision, por është transport, se s'më kujtohej. Transporti i gasit ... sepse është i lëngët, transportohet veç nuk bartet, por është edhe lëmi i transportit. Jo, bartja është që shkon nëpër gypa, transporti është kur e qet në kamion, e bartë të lëngët. Po, po, është tjetër termin transporti gjithkund, e pash edhe në legjislaturën tjetër që e kanë edhe kojshitë e kanë edhe transportin, bile, transporti është gjerësisht te gasi prezent.

Tjetër diçka nuk kam. Domethënë, ka nevojë dhe mund të harmonizohen terminologjia në fillim dhe një term kur në të gjitha ligjet të jetë i njëjtë ky definicion, mos të ketë për të njëjtën gjë dy definicione se pastaj të qesin në lajthitje, cili është më meritor. Kështu që, ka disa, por janë të... po them, ligjet janë shumë të punuara mirë dhe qëllimi i tyre që të përfshihet pakoja e tretë në to është realizuar. Plotësisht, pakoja e tretë reflektohet në ligje, absolutisht, domethënë në përpikëri dhe me përgjegjësi. Por, ka nevojë për rregullime të cilat janë shumë lehtësisht të rregullueshme.

SABIT GASHI: Sa i përket Ligjit të gasit natyror, me thënë të drejtën, e kemi pasur ekspertizën e komunitetit të energjisë shumë aktive në atë fushë, se jemi pa ekspertizë, s'kemi qenë të mjaftueshëm. BLN-në e kanë hequr ata, gazin e ... të... e kanë hequr me një arsye, sepse ai vjen në shprehje vetëm kur ke detin, domethënë kur e ke detin dhe ne s'e kemi menduar që do të kemi... do të marrim në Shqipëri një det e si me thënë, një pjesë, e ta biem këtu gasin. Kjo ka qenë arsyeja dhe ata, se në disa shtete nuk aplikohet ky gaz i lëngëzuar, se teknologjikisht ai përdoret vetëm kur bartet me tankerë të mëdhenj, pastaj prapë ka me hy në sistem gypsjiellësi, ta zëmë, është menduar në Fier me qenë një dhe kur ka probleme atëherë përdoret si rezervat më shumë, se sa si një instrument tjetër për furnizim. Kjo ka qenë.

(Ndërprerje incizimi.)

ALI HAMITI: Po dua të them, gaz i deponohet, për energjinë elektrike kemi problem, që s'mund ta deponojmë, se gaz i deponohet dhe ti mund të kesh rezerva sa të duash edhe sikur mos të bien prej Rusie, nëse ke ti vend ku ta deponosh, ti e ke këtu edhe kur e shtrëngojnë ata ventilin atje.

Kështu që, praktikisht...

KRYETARI: Urdhëroni!

SKENDER XANI: nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik.

Desha vetëm të ndalem te rasti i trajtimit të konsumatorëve të cenueshëm, kur është një nga çështjet më elementare se si duhet me i trajtua. Ne e kemi trajtuar faktikisht në ligjin strumbullar, siç është Ligji për energji, ku pastaj përmes Ligjit për energji i definon edhe te Ligji për energji elektrike pak më detajisht.

Sa i përket te rasti i konsumatorit të cenueshëm, mendoj se ky është një term, është i konsultuar bajagi edhe me komunitetin e energjisë dhe është një propozim që na ka ardhur edhe nga komuniteti i energjisë për termin e trajtimit të konsumatorit të cenueshëm dhe ne e kemi adaptuar dhe ka qenë i pranuar edhe në kuadër të tyre edhe besoj që është mirë, relevantë edhe mund ta citoj se është... po, konsumator i cenueshëm është konsumatori shtëpiak, i cili është i kualifikuar për mbrojtje ose ndihmë... vullnet, po. Po, tash përkthimi... po edhe ... në kuadër të kësaj ne e kemi trajtuar... që, Ministria përgjegjëse për Mjedis e ka trajtimin e kësaj seance. Sa i përket te rasti i bartjes, transportimit, transmetimit te rasti i gazit, është një term, e

kemi me mbështetjen edhe të palës nga komuniteti i energjisë, që janë më profesionalë në këtë drejtim, e kemi quajtur faktikisht, është gazi sikur një lëng, që përcillet përmes sistemit të tubacionit, është sikur sistemi i ngrohjes – energjia termike, që vjen nga koogjenerimi, edhe ajo është mjet transmetimi – përcjellje, transmetim, bartje. E ne e kemi akceptuar që është si lloj transmetimi.

Në njëfarë forme edhe energjia elektrike është transmetim, përcillet përmes sistemit. Edhe kjo, vetëm se e ka sistemin e tubacionit. Faleminderit!

(Ndërprerje e incizimit.)

RAIF QELA: Ju, veç lidhur me terminologjinë, i cënueshëm është që mund të ndryshohet, ose të ndreqet, për shkak se ka gabime a të meta. Prandaj, ky term nuk është përkatës dhe ndryshohet, nuk është problem.

(Ndërprerje e incizimit.)

BESIM BEQAJ: Ndoshta, janë çështje teknike dhe definicione të cilat duhet të ndodhin. Sigurisht, se në mes të dy leximeve dhe grupit punues kur të ulet dhe t'i trajtojë këto çështje një nga një, por besoj se sot ndoshta do të duhet të flisnim për substancën të cilën ne mendojmë, se duhet në debat publik ta rregullojmë. Nëse flasim për substancë, ndoshta duhet të flasim nëse kemi çështjen e Ligjit për gazin natyror dhe është diskutuar dhe ka qenë në debate përpara çështja e gazifikimit nëntokësor, duhet të rregullohet kjo çështje, nuk është e rregulluar me ligje. Ne kemi potenciale, ju e dini që në terminologji të reja edhe thëngjilli mund të ketë gazifikim nëntokësor. Besoj, se kjo çështje duhet të rregullohet si çështje e rëndësisë së veçantë, sikurse e patëm atje, tek licencat edhe te gazi e kemi çështje të rëndësisë së veçantë. Është e mira e krejt kësaj, se këto ligje janë bërë si rezultat i kërkesës që e kemi nga ana e traktatit të energjisë dhe ka ekspertizë nga ana e tyre. Nuk ka dilemë a është në harmoni me Ligjet me traktatet apo nuk është, do të thotë, atë dilemë e kemi të hequr, që e kemi te ligjet tjera, por në kuadër të këtyre pastaj të shohim çka ne mund të rregullojmë ende më mirë, që gjërat të mos na mbesin të parregulluara sikurse ka qenë Ligji për energjinë, i cili parimisht kur kemi pasur debatin për shfrytëzim publik, çka nënkuptohet shfrytëzim publik, a nënkupton vetëm operatori publik apo edhe operatori privat. I kemi pasur këto dilema, të cilat kanë ekzistuar përpara, sepse ndoshta nesër do të hapet tregu edhe për shfrytëzim të thëngjillit, i cili mund të bëhet për gazifikim nëntokësor. Besoj, këto gjëra janë, le të themi, pika,

sipas meje, themelore që duhet t'i diskutojmë për përmbajtjen e re të ligjit, ndërsa për atë pjesën terminologjike dhe gjëra tjera, ne... Raifi është një nga njerëzit më të kujdesshëm dhe po na mban kështu në presion gjithherë për kuptimin gjuhësor, por edhe përmbajtjesor, por ta dinë më së pari se cilat janë fokuset tona. A po dëshirojmë që përmes këtyre ligjeve ta rregullojmë ndoshta, edhe licencimin, që është propozim imi dhe kjo është çështje për debat dhe, nëse flasim për gazifikim nëntokësor, a do ta përfshijmë nëpër këto farë procese apo nuk do ta përfshijmë nëpër këto ligje, janë gjëra të cilat duhet të na vijnë si politika.

Unë besoj, që këtu më shumë të fokusohemi te politikat, jo te gjërat teknike, të cilat do t'i bëjmë, se profesori do të punojë bashkë me neve në grup punues, aty do të... por për ne është me rëndësi, aty do t'i trajtojmë të gjitha çështjet teknike, por për ne është me rëndësi t'i dëgjojmë nga ju që jeni përfaqësues sot ë institucioneve të ndryshme edhe të shoqërisë civile, çka ju mendonit se duhet me qenë pjesë shtesë e cila duhet të rregullohet me ligj e që nuk është pjesë e këtij ligji, që e kemi para vetes. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

MENTOR MORINA: Po kthehem te ky termi i “konsumatorit të cenueshëm” apo konsumatorit në nevojë. Pra, unë po i referohem nga fusha e mirëqenies sociale, ne përdorim grupet e cenueshme dhe grupet në nevojë, cilido prej tyre do të thotë nuk është ndonjë problem, sa i përket emërimit, është në përputhje edhe me planin e veprimit social që kërkon traktati i komunitetit të energjisë, kështu që në këtë aspekt është menduar për grupe të cenueshme, meqenëse këto janë grupe të cilat do të identifikohen për t'u liruar nga një lloj pagese e energjisë elektrike. Kështu që, cilido prej termeve të përdorim, nuk bie në kundërshtim me çështjet e fushës sociale.

(Ndërprerje e incizimit.)

ALI HAMITI: ... gazit, po e kthejmë prapë. Ju e dini, që dikur Kosova ka prodhuar gaz shumë, kemi pasur Gazifikimin që ka prodhuar gaz edhe për Hekuranën e Shkupit, për Ferronikel dhe për “Trepçë”. Gazifikimi është si varrezë edhe më tutje me qindra tona e mijëra tonelata, që duhet të dekomisionohet, por dikur ka prodhuar gaz. Dhe, prodhimi i gazit edhe këtu e tutje, edhe nga bio-masa edhe nga... të ripërtërishme të kemi, është si prodhim që ne mund ta bëjmë prej mbeturinave gazin dhe duhet me e shti në sistem. Pse s'e kemi ne portin që me marrë me shumicë me tankerë, ne

mund të prodhojmë lokalist gaz i cili duhet të përdoret, domethënë duhet të hyjë në sistem.

Kështu që, prodhimi nga të ripërtërishme të kemi nja disa herë të përmendet, që gaz mund të prodhohet edhe nga burime të ripërtërishme, siç është biogazi ose edhe prej mbeturinave, prej ujërave të zeza, e tjera, e tjera... që duhet të kihet parasysh. Kush dëshiron të investojë, mundësitë janë dhe ato trajtohen.

(Ndërprerje e incizimit.)

KRYETARI: Urdhëroni, zoti Gashi!

SABIT GASHI: Ministri Beqaj, se ne e kemi pasur ministër, ngriti një çështje jashtëzakonisht të rëndësishme edhe për politikën. Ne si... aty si administratë që jemi, vërtet e shohim të nevojshme, që thëngjilli të trajtohet në mënyrë të veçantë, për shkak të mundësive që i ka Kosove, resurseve dhe në njëfarë forme, gati në asnjë ligj nuk e trajton si duhet këtë produkt, këtë aset kombëtar.

Kështu që, në këtë kuptim e ngriti shumë mirë, por ky ligj nuk trajton thëngjillin, as produktet as nënproduktet e thëngjillit, trajton të gjitha produktet që mund të derivojnë si gaz, mund të futen në siste. Dhe, çkado që futet në sistem i trajton ligji, por gazifikimi, kur e ka burim fosilin, nuk i trajton. Kështu që, ... me iniciativë të vjen që të kemi një ligj, për thëngjillin e të gjitha produktet e nënproduktet e tij, të trajtohen në mënyrë të veçantë. Dhe, a ia lëmë rregullatorit që e rregullon këtë treg a... diçka është e veçantë, por që mungon – mungon. Dhe, ne e ndjejmë që bëjmë propozime politikash e ndjejmë këtë mungesë.

BESIM BEQAJ: Është e vërtetë që kjo nuk trajtohet, por profesori Hamiti e tha goxha qartë në fillim, që shumë vende e kanë një ligj dhe i trajton të gjitha gjërat brenda një ligji, vetëmse shkon me specifikime të caktuara. Unë nuk besoj se do të ishte e dëmshme, që në Ligj për energjinë të trajtohet edhe... ose, për gazin, por më mirë është për energjinë edhe çështja e trajtimit të fosileve. Janë burime të energjisë dhe besoj që me një pjesë tjetër shtesë, mund të rregullohet kjo. E dini, është pjesë e parregulluar, pjesë e cila na ka ngritur shumë probleme gjatë implementimeve që i kemi pasur edhe që janë aktualisht kah ndodhin me investime dhe është mirë që ta rregullojmë, sepse kemi shansin. Për momentin jemi kah bëjmë ligje të

kompletuara të energjisë, domethënë ta rregullojmë edhe këtë, pra. Nuk besoj që s'mund t'i gjejmë vend në katër ligje.

(Ndërprerje e incizimit.)

SALA BERISHA - SHALA: Faleminderit, kryetar!
Përshëndetje për të gjithë!

Unë do të lidhesha rreth termit që nuk është i një rëndësie më të lartë se sa këto temat tjera që u përmendën edhe nga zoti Beqaj edhe nga përfaqësuesi i Ministrisë. Këtu te përkufizimi, te neni 3, konsumatori i ceneshtëm, ne mund ta gjejmë një shprehje të përbashkët që i përmend të dy kategoritë dhe që e përmendi përfaqësuesi i ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe quhet – konsumator në asistencë, që i kupton ato kategori. Kjo është pak me rëndësi.

E rëndësishme është që dëgjimet publike organizohen nga Kuvendi në mënyrë që të marrim analiza nga ekspertë të ndryshëm siç janë në këtë përbërje dhe kisha kërkuar, e që ndoshta e ka përmendur kryetari në fillim të takimit, sepse erdha unë pak me vonesë, që të gjitha vërejtjet e sugjerimet që mendoni se duhet të inkorporohen në ligje t'i sjellni me shkrim dhe besoj që një pjesë e juaja do të jenë edhe pjesë e grupeve punuese gjatë dy leximeve të Ligjit.

E sa i përket rregullimit me ligj të çështjes së gazit që nënkuptohet edhe me produktet e fosileve, jemi të gatshëm dhe inicioni ju si Ministri e Zhvillimit Ekonomik ose ne sepse kemi traditë të bëjmë nisma ligjore edhe si Komision. Këto çështje përmenden dhe vetëm pak preken te Ligji i minierave. Gjithmonë te Ligji i minierave në kontekst si shfrytëzim i rezervave minerale por jo edhe produktet dhe nënproduktet e tyre.

Në qoftë se e mendoni që e kompletton ndonjërin nga ligjet, ... Edhe ligj i posaçëm për fosile apo të futet me ndonjë nen të veçantë në këto ligje që i kemi në procedurë, ndoshta e kemi rastin dhe mundësinë të punojmë tani në vazhdimësi, edhe pse është një e mirë që këto ligje janë në konsultim dhe në harmoni me komunitetin e energjisë kështu që si grup punues dhe si deputetë do ta kemi shumë lehtë të punojmë më tutje. Faleminderit!

NEZIR MYRTAJ: Përshëndetje! Jam Nezir Myrtaj nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Kam dëshirë të ndërlihem me këtë temën që u hap. Sa i përket Ligjit për gazin natyror unë shpresoj se te Ligji i energjisë

termike duhet të jetë e përmendur edhe çështja e rregullimit të gazit të lëngëzuar të naftës dhe këtu te ky ligj është fokusuar çështja te gazi natyror, në përgjithësi te rregullimi komplet i kësaj fushe, prandaj nëse ndërlidhet çështja edhe me forma tjera të shfrytëzimit të burimeve fosile, për qëllime të prodhimit të gazit, unë mendoj se ligji duhet të jetë në konsistencë edhe me synimet strategjike. Te strategjia e energjisë së Kosovës, unë e di ... ekzistues dhe tash jemi në fazën e draftimit tjetër. Nuk është parashikuar ose së paku s'i është dhënë rëndësi prodhimit të gazit prej burimeve fosile.

Në aspektin e diskutimit të mëhershëm që u përmend për licencat dhe në këtë duke pasur referencë te pengesat që janë bërë në zhvillimin e projekteve, sidomos të burimeve të ripërtëritshme, kur disa vendburime ujore janë marrë autorizimet për to dhe pastaj i kanë mbetur peng i autorizimit zhvillimi i atyre potencialeve energjetike.

Mendoj se çështja ka të bëjë me ndërtimin dhe autorizimin. Do të thotë Zyra e Rregullatorit të Energjisë duhet të ketë kriter ose ndoshta t'i ndryshojë kriteret për dhënien e autorizimit në mënyrë që pala që e merr autorizimin final për ndërtim të kapaciteteve të reja energjetike, duke përmbajtur këtu në mënyrë strikte kërkesat ligjore. Përndryshe, në momentin kur ajo palë e merr licencën, besoj se aty është një kontroll i rreptë i zbatimit të licencës sepse licenca lëshohet për një aktivitet të caktuar energjetik.

Mendoj se është me vend kjo çështja që të kihet një kontroll mbi ata që marrin autorizimin dhe nuk e zbatojnë kërkesën e autorizimit, kurse sa për licencat mendoj se kjo ka të bëjë me ndërtimin e kapaciteteve të reja, jo me licenca. Faleminderit!

AFRIM AJVAZI: Jam Afrim Ajvazi nga Zyra e Rregullatorit për Energji. Sa për informim tuajin, komentet me shkrim i kemi dërguar të premten e kaluar dhe kanë të bëjnë me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe në koment e kemi në Ligjin për energjinë elektrike.

Tani vetëm sa të ndërlidhem me këto dy çështjet që u ngritën këtu. Ligji për rregullatorin e energjisë, edhe në versionin e kaluar ne kemi konsideruar mjaft kompatibil me pakon e dytë të legjislacionit të EU, ndërsa pakoja e tretë, e gjithë ajo që është bërë me Zyrën e Rregullatorit janë të inkorporuar dhe mendoj që Ligji për rregullatorin e energjisë është në një version mjaft të mirë, në përputhje do të thotë me pakon e tretë.

Ligji për energjinë elektrike. Ky ligj, do të thotë pakoja e tretë, në këtë ligj ka sjell ndryshime më të mëdha. Këtu prej momentit të parë, si anëtar të Komisionit kemi pasur vështirësi në transpozimin e pakos së tretë dhe ende mendojmë që kanë mbetur pjesë që duhet sqaruar dhe një prej atyre çështjeve veç u ngrit këtu e ka të bëjë me shthurjen pronësore të operatorit të sistemit të transmissiionit prej gjeneratorit për shkak se legjisllacioni i EU nuk lejon që një pronar t'i mbajë dy ndërmarrje, njëra që ka të bëjë me rrjetin dhe tjetra me gjenerimin. Dhe mendoj se as ky projektligj nuk e ka zgjidh ende këtë çështje. Kjo u ngrit edhe përfaqësuesit të operatorit të sistemit të transmissiionit dhe prej Sabitit qysh në fillim.

Dhe çështja e tretë, që ka të bëjë me ndërtimin e kapaciteteve të reja ... Ligji për Rregullatorin e Energjisë e ka dispozitën shtyllë që thotë mos shko me tender por shko me autorizim.

Ky ligj mendojmë se është i mjaftueshëm të përmbajë këtë dispozitë e pastaj me legjisllacioni detyësor zgjidhen çështjet që u ngritën prej deputetit Beqaj.

Ne edhe vitin e kaluar jemi munduar që atë rregull, që quhet rregulli për procedurën e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese, jemi munduar pra ta bëjmë sa më të aplikueshme dhe sa për informimin tuaj edhe në nivel të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik është diskutuar dhe mendohet të themelohet një ONE-stop-shop ose një grup koordinues i cili ka për qëllim thjeshtësimin e këtyre procedurave që u ngritën nga deputeti. Faleminderit!

BESIM BEQAJ: Nuk desha të hy në detaje, por meqenëse u ngrit kjo çështja e rregullatorit. Profesori Mustafa tha që kanë ngelur disa gjëra të pa rregulluara dhe tash po tentojmë t'i rregullojmë. Unë mund të ju them nga praktika, ne kemi provuar atëherë të rregullojmë procedura për autorizim, por procedurat të cilat rregullohen në bazën ad-hoc dhe varen vetëm nga një institucion, unë nuk mendoj se janë procedura më të mira të mundshme, sepse janë procedura që merren lehtë, hidhen lehtë, kthehen mbrapshtë, kthehen prapë kontra, që do të thotë se ajo nuk është rruga më e mirë.

Ne kemi problem në praktikë. Sa të doni mund të ju numëroj raste konkrete. Kur komuna ia ka dhënë dikujt lejen e ndërtimit, ju ia keni dhënë dikujt tjetër lejen, dhe i keni rastet në dashi në Prizren, në dashi në Junik, në dashi në Pejë, e keni dhënë një autorizim dhe komuna tash e cenon atje vendin, përmes kuvendeve komunale. Janë procedura të cilat duhet të rregullohen. Dhe ky rregullim, besoj se duhet të bëhet me ligj, jo me procedura të tilla,

me akte me të cilat ndoshta vinë më vonë. Mirëpo, me këtë ligj duhet të rregullohen dhe përcaktohen si të tilla, sepse ka probleme në praktikë.

Ndoshta ju e dini më mirë, por unë sa kama informacion, një numër i madh i lokacioneve janë dhënë autorizime për ndërtim të kapaciteteve. Pra, a është e vërtetë?

(Ndërhyrje – nuk dëgjohej qartë për transkriptim)

Mirë, por sa janë prej tyre të cilat nuk e kanë nisur asnjë hap.

(Ndërhyrje – nuk dëgjohej qartë për transkriptim)

KRYETARI: Mirëpo, propozimi i zotit Beqaj është me vend, sepse duhet sqaruar. Do të thotë, procedurën që mos të ketë konflikt të dy institucioneve, komunës dhe ZRRE-së, këtu qëndron çështja.

BESIM BEQAJ: Unë e di që secili institucion duhet të mbrojë pozicionin e vet dhe mbron punën e vet të cilën e ka bërë. Është logjike dhe mos të ishte ashtu, s'duhet të jemi hiq në pozicionet ku jemi dhe nëse s'e mbrojmë atë.

Unë e di se ka rezistencë në forma dhe ndryshime. Dhe kjo është njerëzore. Kërkesa është që ne t'i caktojmë rregullat dhe procedurat që janë shumë më transparente e më të hapura. Kjo është kërkesa dhe besoj se kjo mund të bëhet me ligj. Nuk ka kërkesë për asnjë ekstravagancë këtu por ka kërkesë për definim të qartë të procedurave për autorizime respektivisht harmonizimin e këtyre procedurave me vendimet e komunave. Kjo nuk është e rregulluar. A ka kaq, apo aq, a janë 18 apo kaq milionë, por 18 prej save janë në proces dhe sa janë të autorizuara, dhe sa kanë filluar të punojnë, edhe këtu ka debat dhe nëse domi të hapim debat atëherë mund të hapim debat edhe për këtë. Prej 18 sa janë tjera të autorizuara të cilat nuk kanë filluar asnjë punë ta bëjnë.

Prandaj në këtë drejtim kërkesa është që, po e them prapë, përgjegjësia është e juaja. Ne në Kuvend do të kërkojmë që këto çështje të rregullohen siç është miri dhe të mos lejoni diskrecion të palëve. Na ka dhënë përshtypje të keqe kur gjërat mbesin në diskrecion vetëm të institucioneve. Faleminderit!

KRYETARI: Këtu është intenca që t'u lehtësohen investitorëve që ta kenë adresën e qartë dhe kompetencat të mos përzihen midis institucioneve por të

jenë të definuara qartë. Besoj se është e mundur kjo të arrihet me tekstin e ligjit.

A ka kush edhe diçka të shtojë, apo ta përfundojmë? Athëherë, ju falënderoj dhe mendoj që kishim një shkëmbim të mendimeve për çështjet kyçe, sepse këto janë të gjitha ligje që e rregullojnë këtë sektor dhe janë të lidhura njëra me tjetrën, dhe ne i kemi grupet e veçanta punuese për secilin ligj që do të punohet, por në këtë diskutim kemi konsideruar se mund këto çështjet kyçe e strategjike të diskutohen në pako dhe tash do të kishim lutur që të jepni kontributet tuaja me shkrim për atë që mendoni se mund të ketë ndonjë amendament apo ndryshim dhe e falënderojmë NDP për këtë kontributin që e ka dhënë me shkrim lidhur me ZRRE. Ka edhe analizë krahasuese me vendet tjera dhe disa dilema, disa propozime lidhur me mënyrën e zgjedhjes së Bordit të ZRRE-së dhe besoj që grupi punues do t'i shikojë me kujdes dhe do të vazhdojmë tutje. Lidhur me këtë, siç thash, kemi pasur edhe rekomandime që i ka aprovuar Kuvendi, kur i kemi trajtuar raportet e këtyre organeve e agjencive të pavarura.

Pra, unë e falënderoj edhe Ministrinë, zotin Gashi dhe të gjithë tjerët, edhe zotin Hamiti këtu që kanë kontribuar në krijimin e një pako që është, të them, afër apo është në harmoni me standardet e komunitetit të energjisë.

Ato që i trajtuam këtu, janë disa çështje që mund të rregullohen e të precizohen më mirë dhe mendoj që në bashkëpunim edhe me njerëzit që kanë marrë pjesë në tërë procesin dhe grupet punuese këto çështje që sot i evidentuam eventualisht mund të rregullohen edhe më mirë me ndonjë amendament dhe unë ju inkurajoj që të vazhdoni punën gjatë kësaj jave, mundësisht edhe të përfundojmë diku me amendamente edhe javën tjetër, për arsye se e kemi edhe në kërkesë nga Kryesia e Kuvendit që këto ligje t'i procedojmë. U tha edhe në fillim se jemi vonuar pak me aprovimin e tyre.

A dëshiron ndokush të shtojë edhe diçka? Atëherë, ju faleminderit dhe mirupafshim!